

Njoftim për praktikat e privatësisë

Ne jemi të përkushtuar ndaj privatësisë tuaj

Privatësia e informacionit tuaj mjekësor ka qenë gjithmonë një prioritet në Corewell Health. Ky njoftim u ofron pacientëve të Corewell Health dhe familjeve të tyre informacionin e nevojshëm për të drejtat e tyre të privatësisë dhe angazhimin e vazhdueshëm të Corewell Health për të mbrojtur këto të drejta. Ju keni të drejtë të zgjidhni mënyrën e mbledhjes dhe përdorimit të informacionit që lidhet me shëndetin.

Pyetje apo shqetësime

Corewell Health, Chief Privacy Officer MCI68, 100 Michigan Street NE, Grand Rapids, MI 49503

· Telefononi në: **616.486.4113**

· Dërgoni e-mail në: privacy@corewellhealth.org

Njoftim i përbashkët për praktikat e privatësisë

Ky njoftim përshkruan mënyrën e përdorimit dhe dhënies së informacionit tuaj mjekësor dhe mënyrën se si veprohet për të pasur qasje te ky informacion. **Ju lutemi, lexoni me kujdes këtë njoftim.** Ky njoftim është i vlefshëm që prej datës 17 gusht 2023.

Nëse keni pyetje lidhur me këtë njoftim, kontaktoni Kryeoficerin e Privatësisë të Corewell Health me e-mail në adresën privacy@corewellhealth.org ose duke përdorur të dhënat e mësipërme të kontaktit.

Kush do ta ndjekë këtë njoftim?

Ky njoftim vlen për "Corewell Health" ose "Corewell Health facilities", duke përfshirë edhe spitalet, qendrat e të moshuarve, urgjencat, personelin tonë mjekësor, agjencitë që ofrojnë shërbime kujdesit mjekësor në banesë, azilet, klinikat, zyrat dhe objektet që operohen nga Corewell Health. Ky njoftim do të ndiqet nga të gjitha ndërtesat dhe zyrat e Corewell Health, pavarësisht nëse janë të renditura, apo jo. Ndryshimet në këtë Njoftim të Praktikave të Privatësisë janë të disponueshme në zyrën ose ndërtesën ku po merrni shërbimet mjekësore dhe mund të merren duke telefonuar në numrin **616.486.4113** ose duke dërguar e-mail në adresën privacy@corewellhealth.org. Ky njoftim është i vlefshëm edhe për subjektet që janë pjesë e "Corewell Health's Organized Health Care Arrangement (OHCA)" (Marrëveshjes së Organizuar të Shërbimeve Mjekësore të Corewell Health). Këto subjekte do të ndajnë informacionin tuaj shëndetësor të mbrojtur (PHI) me njëri-tjetrin për qëllime të trajtimit, pagesës dhe operacioneve të shërbimeve mjekësore.

Corewell Health ruan të drejtën për të ndryshuar pjesëmarrjen në OHCA nga çdo individ apo institucion. Nëse keni pyetje për statusin e pjesëmarrjes së një ofruesi të shërbimeve mjekësore në OHCA, telefononi në numrin **616.486.4113** ose dërgoni e-mail në adresën privacy@corewellhealth.org.

Zotimi ynë për informacionin tuaj shëndetësor

Ne e kuptojmë se informacioni juaj shëndetësor është personal dhe ne jemi të përkushtuar për mbrojtjen e tij. Informacioni juaj shëndetësor që përdorim, krijojmë, mbajmë dhe japim mund të lidhet me shërbimet mjekësore për shëndetin fizik dhe mendor që merrni nga ne. Ne krijojmë një regjistër të shërbimeve mjekësore që merrni në Corewell Health. Ky procesverbal na lejon t'ju ofrojmë shërbime mjekësore cilësore dhe të përmbushim disa kërkesa ligjore. Ky njoftim vlen për të gjitha të dhënat që lidhen me shërbimet tuaja mjekësore, të cilat ruhen nga Corewell

Health, në formë elektronike ose të printuar. Nëse mjeku që kujdeset për ju nuk është anëtar i ekipit të Corewell Health, ai mund të zbatojë politika ose njoftime të ndryshme për përdorimin dhe dhënien e informacionit tuaj mjekësor. Ky njoftim ju informon për mënyrat e përdorimit ose dhënies së informacionit tuaj shëndetësor. Në të përshkruhen edhe të drejtat tuaja dhe detyrimet tona për përdorimin dhe dhënien e informacionit shëndetësor.

Ne jemi të detyruar me ligj që:

- Të ruajmë privatësinë dhe sigurinë e informacionit tuaj shëndetësor të mbrojtur (PHI).
- Të ndjekim praktikat e privatësisë që janë përshkruar në këtë njoftim dhe t'ju japim një kopje të tij.
- Të njoftojmë individët e prekur në vijim të ndonjë shkeljeje të detyrimit të mbrojtjes së sigurt të informacionit tuaj shëndetësor.

Si mund të përdorim dhe japim informacionin tuaj shëndetësor

Ekzistojnë situata të shumta në të cilat ne mund të përdorim dhe të japim informacion për shëndetin tuaj pa pëlqimin tuaj të dhënë me shkrim. Sidoqoftë, përdorimi dhe dhënia në rastet e ndryshme nga sa përshkruhet në vijim do të kryhet vetëm me lejen tuaj. Autorizimi juaj me shkrim kërkohet për të përdorur ose dhënë informacionin tuaj shëndetësor në disa rrethana të caktuara. Për shembull, ne nuk do të shesim kurrë të dhënat tuaja dhe as nuk do t'i përdorim ato për qëllime marketingu pa lejen tuaj. Kategoritë e mëposhtme përshkruajnë mënyra të ndryshme të përdorimit dhe dhënies së informacionit shëndetësor.

Për trajtimin mjekësor:

Ne mund të përdorim informacionin tuaj shëndetësor dhe t'ia japim atë profesionistëve të tjerë të përfshirë në trajtimin tuaj mjekësor. Sjellim si shembull rastin kur një mjek që ju trajton për një dëmtim pyet një ofrues tjetër të shërbimeve mjekësore për gjendjen tuaj të përgjithshme shëndetësore. Ne mund të japim informacion për shëndetin tuaj për vazhdimësinë e shërbimeve mjekësore të nevojshëm. Departamente të ndryshme të Corewell Health mund të japin informacionin tuaj shëndetësor për të koordinuar veprimet e ndryshme që nevojiten, si për shembull përgatitja e recetave mjekësore, puna në laboratorë, radioskopitë apo terapitë, si dhe koordinimi i rekomandimeve. Ne mund t'ua japim informacion për shëndetin tuaj palëve të ndryshme jashtë rrjetit Corewell Health, të cilët janë përfshirë në kujdesin shëndetësor që ju ofrohet pas trajtimit në Corewell Health, si për shembull tek anëtarët e familjes ose agjencitë shëndetësore që ofrojnë shërbime në banesë. Ne mund t'ia japim informacion për shëndetin tuaj një ofruesi tjetër të shërbimeve mjekësore, tek i cili jeni referuar ose transferuar për shërbime të mëtejshme të shërbimeve mjekësore. Ofruesit e shërbimeve mjekësore jashtë rrjetit Corewell Health që janë të përfshirë në trajtimin tuaj mjekësor duhet të kenë qasje në informacionin tuaj shëndetësor më të plotë të mundshëm me qëllim që të jenë në gjendje të marrin vendime për shërbimet mjekësore shëndetësore ndaj jush. Këta ofrues mund të kenë qasje në të dhënat tuaja në formë elektronike dhe të printuar, të ruajtura nga Corewell Health për këtë qëllim. Gjithashtu, në rastet kur këta ofrues ju kanë referuar në Corewell Health për trajtim mjekësor, ata mund të kenë qasje në të dhënat tuaja dhe në informacionin tuaj shëndetësor për të ndjekur ecurinë e trajtimit mjekësor. Corewell Health zbaton procedura dhe përdor teknologji të ndryshme për të mbrojtur privatësinë dhe sigurinë e të dhënave tuaja në raste të tilla.

Kundrejt pagesës: Ne mund të përdorim dhe japim informacion shëndetësor dhe jo shëndetësor për të faturuar dhe për të marrë pagesat nga kompanitë e sigurimit shëndetësor ose nga subjekte të tjera për trajtimin dhe shërbimet që merrni në Corewell Health. Për shembull, ne mund të japim informacion për ju te kompania e sigurimit tuaj shëndetësor në mënyrë që ajo të paguajë shpenzimet e shërbimeve apo kujdesit mjekësor. Ne mund t'i tregojmë kompanisë së sigurimit tuaj shëndetësor për një trajtim mjekësor që do të merrni për të marrë miratimin paraprak ose për të përcaktuar nëse kompania e sigurimit do të mbulojë trajtimin. Disa ofrues që ofrojnë shërbime te Corewell Health faturojnë veçmas dhe ne mund t'u sigurojmë atyre informacion në lidhje me pagesën për të koordinuar procesin e faturimit dhe të pagesës. Gjithashtu, ne mund t'ju kontaktojmë me shkrim ose me telefon për të diskutuar mbi llogarinë tuaj ose për të verifikuar apo mbledhur më shumë informacion rreth mbulimit tuaj nga sigurimi shëndetësor. Nëse keni paguar plotësisht për një produkt ose shërbim mjekësor dhe na thoni se nuk dëshironi që kompania e sigurimit tuaj shëndetësor të marrë informacion në lidhje me atë produkt ose shërbim, ne nuk do ta japim informacionin përkatës të planit të sigurimit tuaj shëndetësor, përveçse në rastet kur kjo gjë na kërkohet sipas ligjit.

Për veprimtarinë e shërbimeve mjekësore: Ne mund të përdorim dhe të japim informacion për shëndetin tuaj për të drejtuar biznesin tonë, të tilla si kontabiliteti, përpunimi i kërkesave për dëmshpërblim ose për të vlerësuar forcën tonë të punës. Në këto raste, përdorimi dhe dhënia janë të nevojshme për të drejtuar veprimtarinë operacionale të Corewell Health dhe për të garantuar cilësinë e shërbimeve për pacientët tanë. Për shembull, ne mund të japim të dhënat tuaja te Priority Health, një kompani e sigurimit shëndetësor në pronësi të Corewell Health, si pjesë e Marrëveshjes sonë të Kujdesit Shëndetësor të Organizuar (OHCA). Ndarja e informacionit me Priority Health na ndihmon të arrijmë objektivat e sistemit tonë shëndetësor të integruar, siç janë përmirësimi i cilësisë, menaxhimi i shëndetit të popullsisë dhe përmirësimi i shëndetit e mirëqenies së përgjithshme të komuniteteve të cilave u shërbejnë Corewell Health dhe Priority Health. Ne mund të përdorim gjithashtu informacion të caktuar mjekësor dhe jo-mjekësor për t'ju kontaktuar dhe për t'ju marrë mendim lidhur me cilësinë e shërbimeve që keni marrë nga Corewell Health dhe për përmirësimin e shërbimeve tona. Ne mund të kombinojmë edhe informacionin shëndetësor për shumë pacientë për të vendosur lidhur me shërbimet shtesë që duhet të ofrojë Corewell Health, shërbimet e panevojshme dhe efikasitetin e disa trajtimeve të reja. Ne mund t'u japim informacion mjekësor, infermierëve, teknikëve, studentëve të mjekësisë dhe shërbimeve shëndetësore, si dhe personelit më të gjerë të spitalit për qëllime arsimimi. Ne mund të kombinojmë informacionin shëndetësor që kemi së bashku me informacionin shëndetësor nga organizata të tjera për të krahasuar performancën tonë dhe për të përcaktuar se si mund të përmirësojmë kujdesin shëndetësor dhe shërbimet që ofrojmë.

Përdorimi dhe dhënia e informacionit aksidentalisht: Ne mund të përdorim ose të japim informacion për shëndetin tuaj kur kjo gjë lidhet me përdorimin ose dhënien e informacionit për arsye të tjera që lejohen ose kërkohen me ligj. Për shembull, bisedat midis mjekëve, infermierëve ose personelit më të gjerë të Corewell Health në lidhje me gjendjen tuaj mjekësore ndonjëherë mund të dëgjohen. Ju lutemi të siguroheni që të keni marrë masat e nevojshme mbrojtëse për të shmangur situata të tilla sa më shumë që të jetë e mundur.

Kujtesat për takimet: Ne mund të përdorim dhe të japim informacion për shëndetin tuaj gjatë kujtesave për takime të ardhshme në ndërtesat e Corewell Health ose për përgatitjen e një recete mjekësore.

Veprimtari të mbledhjes së fondeve: Në rastin e mbledhjes së fondeve, ne mund të përdorim informacion të caktuar jo mjekësor, duke përfshirë por pa u kufizuar në të dhëna si emri juaj, adresa, numri i telefonit, datat dhe vendi i shërbimit, mosha dhe gjinia, për t'ju kontaktuar me qëllim mbledhjen e fondeve në para për bashkëpunëtorët e Corewell Health përmes një fondacioni në pronësi të Corewell Health ose të kontrolluar prej saj. Paratë e mbledhura do të përdoren për të zgjeruar dhe për të përmirësuar shërbimet dhe programet që i ofrojmë komunitetit. Ju keni të drejtë të "hiqni dorë" nga përdorimi dhe dhënia e informacionit tuaj për qëllime të mbledhjes së fondeve.

Direktoria e spitalit: Gjatë kohës që jeni pacient në një spital të Corewell Health, ne mund të përfshijmë informacion të kufizuar për ju në direktorinë e spitalit. Ky informacion mund të përfshijë të dhëna si emri, vendndodhja në spital, gjendja juaj të përgjithshme (p.sh., e kënaqshme, e qëndrueshme, etj.) dhe përkatësinë tuaj fetare. Ky informacion mund t'u jepet edhe njerëzve që ju kërkojnë me emër, me përjashtim të informacionit për përkatësinë suaj fetare. Për më shumë, spitali mund të mbajë një direktori të veçantë ku renditet përkatësia juaj fetare dhe t'ua japë këtë direktori anëtarëve të klerikëve. Kjo bëhet me qëllim që familja, miqtë dhe përfaqësuesit e besimit fetar përkatës të mund t'ju vizitojnë në spital dhe të dinë gjendjen tuaj të përgjithshme. Ju keni të drejtë të na kërkoni të kufizojmë (të reduktojmë ose të mos përfshijmë) informacionin tuaj në direktoritë e spitaleve. Nëse dëshironi të caktohen kufizime, na e kërkoni këtë gjatë regjistrimit.

Individët e përfshirë në programin e kujdesit shëndetësor ose në pagesën e shërbimeve përkatëse: Informacioni juaj shëndetësor mund t'i jepet një miku ose anëtar të familjes që është i përfshirë në shërbimet e kujdesit tuaj shëndetësor për sa kohë që nuk keni kundërshtuar ose në rastet kur besojmë se dhënia e informacionit është në interesin tuaj më të mirë. Ne mund t'i japim informacion edhe një personi që është përfshirë në kryerjen e pagesave ose ju ndihmon me pagesat e shërbimeve të kujdesit tuaj shëndetësor. Ne mund t'i tregojmë familjes dhe miqve tuaj për gjendjen tuaj të përgjithshme. Për më tepër, ne mund të japim informacion lidhur me shëndetin tuaj te një subjekt që ndihmon në një përpjekje për lehtësimin e fatkeqësive, në mënyrë që familja juaj të mund të njoftohet për gjendjen, statusin dhe vendndodhjen tuaj.

Hulumtime: Në rrethana të caktuara, ne mund të përdorim dhe të japim informacionin tuaj shëndetësor për qëllime studimore. Për shembull, një projekt kërkimor mund të përfshijë vlerësimin e shëndetit dhe shërbimit të pacientëve që kanë marrë një medikament në krahasim me pacientë që kanë përdorur medikament tjetër për të njëjtën gjendje. Të gjitha projektet studimore i nënshtrohen një procesi të veçantë miratimi. Ky proces vlerëson projekt studimor të propozuar dhe përdorimin e informacionit shëndetësor prej tij. Ky proces garanton gjithashtu balancimin e nevojave të hulumtimit me nevojat e pacientëve tanë sa i përket privatësisë së informacionit të tyre shëndetësor. Para se të përdorim ose japim informacion për shëndetin tuaj për qëllime studimore, projekti do të rishikohet përmes procesit të miratimit të hulumtimit. Megjithatë, ne mund të japim informacionin tuaj shëndetësor te njerëzit që përgatiten të kryejnë një projekt studimor. Si shembull, ne mund t'u japim informacion studiuesve për t'i ndihmuar ata të kërkojnë pacientë me nevoja specifike mjekësore,

për sa kohë që informacioni shëndetësor që ata shqyrtojnë nuk largohet nga Corewell Health. Në rastet kur studiuesi do të ketë qasje në të dhënat si emri, adresa e banimit apo të dhëna të tjera personale, ose nëse do të përfshihet në shërbimet mjekësore tuaj lidhur me studimin në Corewell Health, mund të nevojitet të kërkojmë lejen tuaj të posaçme.

Siç parashikohet me ligj: Ne do të japim informacion për shëndetin tuaj kur kjo kërkohet nga legjislacioni në fuqi, rregulloret federale, shtetërore ose lokale. Sjellim si shembull rastin kur ligji parashikon që të na kërkohet të raportojmë lëndime ose sëmundje të caktuara për qëllime të mbajtjes së shëndetit publik.

Për të shmangur një kërcënim serioz për shëndetin ose sigurinë: Ne mund të përdorim dhe japim informacion për shëndetin tuaj kur është e nevojshme për të parandaluar një kërcënim serioz për shëndetin dhe sigurinë tuaj ose shëndetin dhe sigurinë e publikut ose të një personi tjetër. Informacionin tuaj do t'ia japim vetëm personave që janë në gjendje të ndihmojë në parandalimin e kërcënimit.

Komunikimet për programet ose produktet e Corewell Health: Ne mund të përdorim dhe të japim informacion për shëndetin tuaj për arsye informimi rreth një produkti ose shërbimi shëndetësor të Corewell Health. Për më tepër, ne mund të përdorim ose të japim informacion për shëndetin tuaj për t'ju informuar lidhur me produktet ose shërbimet që lidhen me trajtimin tuaj, menaxhimin e rasteve, koordinimin e shërbimeve mjekësore, komunikimin e trajtimeve alternative, terapive, ofruesve të shërbimeve mjekësore ose parametrat e kujdesit shëndetësor. Ne mund t'ju informojmë herë pas here për produktet ose shërbimet e një kompanie tjetër por do të përdorim ose japim informacion për shëndetin tuaj vetëm nëse komunikimet do të ndodhin personalisht.

Shkëmbimi i informacionit shëndetësor: Corewell Health regjistron dhe dërgon informacionin shëndetësor, duke përfshirë edhe informacion për recetat mjekësore elektronike. Informacioni shëndetësor ndahet në formë elektronike për qëllimet e përshkruara në këtë njoftim dhe mbrohet përmes shkëmbimit të informacionit në nivel vendor, shtetëror dhe kombëtar. Corewell Health merr pjesë në shkëmbimet e informacionit shëndetësor, duke përfshirë rrjetin MiHIN (Rrjetin e Informacionit Shëndetësor të Michigan-it), dhe mund të marrë pjesë në shkëmbime informacioni të tjera në të ardhmen. MiHIN funksionin sipas rregullave të përcaktuara për mënyrën e qasjes në informacionin shëndetësor përmes shkëmbimit dhe kufizon përdorimin dhe dhënien e këtij informacioni. Për më shumë informacion lidhur me rrjetin MiHIN dhe të drejtat tuaja për dërgimin e informacionit tuaj përmes tij, mund të dërgoni e-mail në adresën privacy@corewellhealth.org.

Epic's Care Everywhere: Të dhënat tuaja mjekësore ruhen në formë elektronike në programin kompjuterik të quajtur Epic. Për të përmirësuar shërbimet mjekësore që merrni, Corewell Health i ndan të dhënat tuaja shëndetësore në formë elektronike me ofruesit e tjerë që përdorin Epic's Care Everywhere. Ne i ndajmë të dhënat për të lejuar ofruesit e tjerë të shërbimeve mjekësore shëndetësor që përdorin Epic, të cilët janë të përfshirë në trajtimin tuaj mjekësor, të shikojnë menjëherë informacionin tuaj mjekësor. Gjatë regjistrimit tuaj në një spital tjetër që përdor Epic, një mjek i atij spitali që merr pjesë në trajtimin tuaj mjekësor mund të kërkojë të dhënat mjekësore nga spitali ynë në formë elektronike. Për shembull, në rast urgjence, një

mjek mund të kërkojë në formë elektronike nga Corewell Health dosjen tuaj mjekësore dhe në vijim, nëse jepet "leja", ai do të shikojë rezultatet e analizave tuaja laboratorike. Ndarja e informacionit tuaj shëndetësor në këtë mënyrë do t'i lejojë mjekut të marrë vendime për trajtimin tuaj sipas një informacioni më të plotë. Ekzistojnë masa mbrojtëse për t'u siguruar që aktualisht po merrni shërbime mjekësore në spitalin kërkues ose nga ofruesi i shërbimeve mjekësore. Ofruesit e shërbimeve mjekësore duhet të kenë informacion të mjaftueshëm për ju me qëllim që të vërtetojnë se po ju ofrojnë shërbime mjekësore DHE ju duhet të regjistroheni si pacient në regjistrin e tyre mjekësor elektronik. Informacioni juaj shëndetësor mund të përfshijë diagnoza që përbëjnë çështje delikate, si për shembull HIV/AIDS, sëmundje që transmetohen seksualisht, informacion gjenetik, shëndeti mendor, abuzimi me substanca, testimi gjenetik, etj. Shënimet e psikoterapisë nuk përfshihen në të dhënat tuaja mjekësore dhe as në shkëmbimin e informacionit shëndetësor nga ana jonë. Nëse dëshironi të "hiqni dorë" nga Epic's Care Everywhere, ju lutemi kontaktoni Zyrrën tonë të Privatësisë në numrin e telefonit ose në adresën e e-mailit të shkruar në kolonën e parë të këtij njoftimi.

Si mund të përdorim ose të japim informacion për shëndetin tuaj – Situata të veçanta

Në shumë raste, ne mund të përdorim dhe të japim informacionin tuaj shëndetësor pa lejen tuaj me shkrim. Më poshtë paraqiten situatat e veçanta kur mund të përdorim ose të japim informacion për shëndetin tuaj.

Dhurimi i organeve dhe i indeve: Nëse jeni dhurues organesh, ne mund t'ju japim informacionin tuaj shëndetësor, sipas nevojës, institucioneve që merren me prokurimin e organeve ose transplantimin e organeve, të syve dhe indeve ose një banke për dhurimin e organeve.

Ushtarakët dhe veteranët: Nëse jeni efektiv i forcave të armatosura, ne mund të japim informacionin tuaj mjekësor siç kërkohet nga autoritetet e komandës ushtarake. Ne mund të japim gjithashtu edhe informacionin shëndetësor për personelin ushtarak të huaj tek autoriteti përkatës ushtarak i huaj. Nëse një anëtar i familjes është në ushtri, në rrethana të caktuara, ne mund t'ju japim informacion për shëndetin tuaj efektivëve ushtarakë ose një agjencie të miratuar të shërbimeve sociale, siç është Red Cross, për të këshilluar anëtarin tuaj të familjes për gjendjen tuaj shëndetësore.

Kompensimi i punëtorëve: Ne mund të japim informacionin tuaj shëndetësor për programet e kompensimit të punëtorëve ose programe të tjera të ngjashme. Këto programe ofrojnë përfitime për rastet e lëndimeve dhe sëmundjeve në punë.

Reziqet për shëndetin publik: Ne mund të japim informacion për shëndetin tuaj për veprimtari të shëndetit publik që përfshijnë:

- Parandalimin ose kontrollin e sëmundjeve, lëndimeve ose paaftësinë.
- Raportimin e lindjeve dhe vdekjeve dhe përfshirjen në regjistrat e sëmundjeve.
- Raportimin e abuzimit të fëmijëve ose neglizhencës ndaj tyre.
- Raportimin e reaksioneve ndaj medikamenteve ose të problemeve me produktet.
- Njoftimin e njerëzimit për nxjerrjen nga qarkullimi të produkteve që mund të përdorin.
- Njoftimin e personave që mund të kenë qenë të ekspozuar ndaj një sëmundjeje ose mund të jenë në rrezik për infektimin me një sëmundje apo përhapjen e saj.

· Njoftimin e autoritetit kompetent qeveritar në rastet kur besojmë se një pacient ka qenë viktimë e abuzimit, neglizhencës ose dhunës në familje. Dhënia e informacionit në këtë rast do të kryhet vetëm nëse jeni dakord ose kur kërkohet ose autorizohet me ligj

Aktivitetet e mbikëqyrjes shëndetësore: Ne mund t'i japim informacion për shëndetin tuaj një agjencie të mbikëqyrjes shëndetësore për veprimtaritë që autorizohen me ligj. Këto veprimtari mbikëqyrëse përfshijnë për shembull auditimet, hetimet, inspektimet dhe licencimet. Këto veprimtari janë të nevojshme për qeverinë në mënyrë që të mundësohet monitorimi i sistemit të shërbimeve mjekësore, programet qeveritare dhe respektimi i legjislacionit për të drejtat civile.

Proceset gjyqësore dhe mosmarrëveshjet: Nëse jeni përfshirë në një proces gjyqësor ose jeni palë në një mosmarrëveshje, ne mund të japim informacion për shëndetin tuaj në përgjigje të urdhrave gjyqësorë ose administrativë. Ne mund të japim gjithashtu informacionin tuaj mjekësor në përgjigje të urdhër-thirrjeve në gjykatë, kërkesave për dhënie informacioni ose të proceseve të tjera të ligjshme nga një person i përfshirë në mosmarrëveshje, por vetëm nëse keni rënë dakord për dhënie të tillë. Megjithatë nuk nevojitet leja juaj nëse kërkesa e dhënies së informacionit është nënshkruar nga një gjyqtar ose është urdhëruar nga një gjykatë.

Zbatim i ligjit: Ne mund t'i japim informacion për shëndetin tuaj një zyrtari të zbatimit të ligjit në rastet e mëposhtme:
Në përgjigje të një urdhri gjyqësor, urdhër-thirrjeje, urdhër-arresti, thirrjeje ose procesi të ngjashëm,
· Për të identifikuar ose për të gjetur një person të dyshuar, të arratisur, dëshmitar material ose një person të zhdukur,
· Në rastet kur informacioni lidhet me viktimë të një krimi dhe nëse, në rrethana të caktuara të kufizuara, ne nuk jemi në gjendje të marrim pëlqimin e personit për dhënien e informacionit,
· Në rastet e një vdekjeje që besohet se mund të jetë rezultat i veprimeve kriminale,
· Në rastet e veprimeve kriminale në një ndërtesë të Corewell Health, ose
· Në rrethana të situatave urgjente për raportimin e një krimi, të vendndodhjes së krimit apo të viktimave ose për identitetin (përshtetësin ose vendndodhjen) e personit që ka kryer krimin.

Mjekët ligjorë, ekspertët e ekzaminimit mjekësor dhe drejtorët e funeraleve: Ne mund t'i japim informacion për shëndetin tuaj një mjeku ligjor ose një ekspert të ekzaminimit mjekësor. Kjo mund të jetë e nevojshme, për shembull për të identifikuar një person që ka humbur jetën ose për të përcaktuar shkaktuesin e vdekjes. Sipas nevojës, ne mund t'u japim informacionin mjekësor të pacientëve edhe drejtorëve të funeraleve për kryerjen e detyrave të tyre.

Veprimtaria që lidhet me sigurinë kombëtare dhe inteligjencën: Ne mund t'u japim informacion për shëndetin tuaj zyrtarëve të autorizuar federalë të shërbimeve të zbulimit (inteligjencës), kundërzbulimit dhe të shërbimeve të tjera të sigurisë kombëtare të autorizuar me ligj.

Shërbimet mbrojtëse për Presidentin dhe persona të tjerë: Ne mund t'u japim informacion për shëndetin tuaj zyrtarëve të autorizuar federalë, në mënyrë që ata të mund të mbrojnë Presidentin, njerëzit e autorizuar, kërret e shteteve të huaja ose për të kryer hetime të veçanta.

Të burgosurit: Nëse ju është hequr liria dhe jeni i burgosur ose nën kujdestarinë e një zyrtari të zbatimit të ligjit, ne mund t'i japim informacion për shëndetin tuaj institucionit ku kryeni dënimin ose zyrtarit të zbatimit të ligjit. Dhënia e informacionit në këtë rast i nevojitet institucionit apo zyrtarit për ofrimin e shërbimeve mjekësore, mbrojtjen e shëndetit, garantimin e sigurisë tuaj dhe të personave të tjerë ose të institucionit ku kryeni dënimin.

Palët e treta: Ne mund të japim informacion për shëndetin tuaj te palë të treta të caktuara, me të cilat kemi lidhur kontratë për të kryer shërbime në emër të një enti shëndetësor të Corewell Health. Në raste të tilla, pala e tretë do të na japë garanci me shkrim për mbrojtjen e informacionit tuaj.

Informacioni tepër konfidencial: Disa të dhëna të informacionit shëndetësor janë subjekt i mbrojtjes së veçantë të privatësisë, si për shembull: shënimet e psikoterapisë, shërbimet për shëndetin mendor dhe aftësitë e kufizuara të zhvillimit, shërbimet e trajtimit të varësisë nga alkooli dhe drogat dhe ato të dhe parandalimit të abuzimit me to, si dhe për sëmundje të caktuara. Ne do të përdorim ose japim informacionin tuaj mjekësor tepër konfidencial vetëm siç lejohet apo parashikohet me ligj ose me lejen tuaj të dhënë me shkrim.

Të drejtat tuaja në lidhje me informacionin tuaj shëndetësor

E drejta për të kontrolluar dhe për të marrë kopje: Ju keni të drejtë të kërkonti të shikoni ose të merrni kopje elektronike ose të printuar të të dhënave mjekësore dhe informacionit shëndetësor që mbajmë për ju. Informacioni i disponueshëm për ju përfshin të dhënat mjekësore dhe të faturimeve por nuk përfshin asnjë shënim psikoterapie. Pyesni Menaxhimin e Informacionit Shëndetësor (HIM) për mënyrën se si veprohet në këtë rast. Ne do t'ju japim një kopje ose një përmbledhje të informacionit shëndetësor, zakonisht brenda 30 ditëve nga data e kërkesës tuaj. Ne mund të zbatojmë një tarifë të arsyeshme, të bazuar në kosto. Në disa rrethana shumë të kufizuara, ne mund të refuzojmë kërkesën tuaj për të inspektuar dhe për të marrë kopje. Në rast refuzimi të qasjes në informacionin tuaj shëndetësor, ju keni të drejtë të kërkonti rishikim të kërkesës. Në këtë rast, kërkesa juaj dhe refuzimi do të rishikohet nga një profesionist tjetër i licencuar i shërbimeve mjekësore që zgjidhet nga Corewell Health. Personi që do të rishikojë kërkesën tuaj do të jetë i ndryshëm nga personi që ka refuzuar kërkesën tuaj fillestare. Ne do të respektojmë rezultatit e shqyrtimit. Nëse merrni pjesë në veprimtari studimore, ne mund të refuzojmë kërkesën tuaj për të inspektuar dhe për të marrë kopje të një pjese të informacionit tuaj shëndetësor në lidhje me atë hulumtim, për sa kohë që keni rënë dakord për këtë kufizim të qasjes në formularin e pëlqimit që keni nënshkruar përpara pjesëmarrjes. Gjithashtu ne mund të refuzojmë qasjen siç parashikohet ndryshe me ligj.

E drejta për ndryshime: Ju keni të drejtë t'i kërkonti HIM (Menaxhimi i Informacionit Shëndetësor) të korrigjojë të dhënat tuaja shëndetësore, të cilat mendoni se janë të pasakta ose jo të plota. Na pyesni për mënyrën se si veprohet në këtë rast. Ne mund t'i themi "jo" kërkesës tuaj por përgjigja jonë do të jepet me shkrim brenda 60 ditëve. Ne mund ta refuzojmë kërkesën tuaj për ndryshim nëse ajo nuk bëhet me kur në kërkesë nuk përcaktohet arsyeja në të cilën bazohet ndryshimi që kërkohet. Ne mund të refuzojmë kërkesën tuaj edhe në rastet kur na kërkonti të ndryshojmë të dhënat që:

· Nuk u krijuan prej nesh, me përjashtim të rasteve kur personi ose subjekti që krijoi të dhënat nuk është më i disponueshëm për të kryer ndryshimin.

- Nuk janë pjesë e informacionit shëndetësor të mbajtur nga ose për një subjekt të Corewell Health.
- Nuk janë pjesë e informacionit që do t'ju lejohej të inspektonit dhe merrni kopje.
- Janë të sakta dhe të plota.

E drejta për listën e rasteve të dhënies së informacionit: Ju keni të drejtë të kërkonit një listë (tabelë) të rasteve kur kemi dhënë informacionin tuaj shëndetësor, palët te të cilat është dhënë informacioni dhe arsyen, për një periudhë kohore gjashtë-vjeçare përpara datës së kërkesës në fjalë. Pyesni HIM (Menaxhimi i Informacionit Shëndetësor) për mënyrën se si vepohet për të paraqitur kërkesën përkatëse. Ne do të përfshijmë në listën përkatëse të gjitha rastet e dhënies së informacionit, me përjashtim të atyre që lidhen me trajtimin, pagesat dhe shërbimet mjekësore, si dhe disa raste të caktuara të tjera (si veprime që na janë kërkuar nga ju vetë). Ne ofrojmë një listë në vit falas por nëse kërkohet një listë tjetër brenda një periudhe 12 mujore, atëherë do të caktojmë një tarifë të arsyeshme sipas kostos. Në kërkesë ju duhet të shkruani formatin në të cilin dëshironi t'u jepet lista (për shembull: e printuar ose në formë elektronike).

E drejta për të kërkuar kufizime: Ju keni të drejtë të na kërkonit të mos përdorim apo japim informacion të caktuar shëndetësor për trajtimet, pagesat ose për operacionet tona. Nëse paguani vetë shumën e plotë të një shërbimi ose produkti të kujdesit shëndetësor, juve ju lind e drejta të kërkonit që ne të mos e ndajmë atë informacion me ofruesin e sigurimit tuaj shëndetësor. Ne do të themi "po" me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon dhënien e informacionit, në rastet kur dhënia e informacionit do të ndikonte në kujdesin tuaj shëndetësor ose nëse nuk jemi në gjendje të përmbushim kërkesën tuaj.

E drejta për të kërkuar komunikim konfidencial: Ju keni të drejtë të kërkonit që komunikimi ynë me ju për çështjet e kujdesit shëndetësor të kryhet në një mënyrë ose në një vend të caktuar. Për shembull, ju mund të kërkonit që t'ju kontaktojmë vetëm në punë ose me postë. Ne do të pranojmë të gjitha kërkesat e arsyeshme. Kërkesa mund të bëhet gjatë regjistrimit, te përfaqësuesi juaj si pacient ose te Zyra e Privatësisë. Ne mund t'u kërkojmë që kërkesa të paraqitet me shkrim.

E drejta për kopje të printuar të këtij njoftimi: Ju keni të drejtë të kërkonit në çdo kohë një kopje të këtij njoftimi. Edhe nëse keni rënë dakord të merrni këtë njoftim në formë elektronike, ju vijoni të keni të drejtë të merrni një kopje të printuar të tij. Kopja e këtij njoftimi mund të gjendet në faqen tonë në internet, corewellhealth.org/policies, ose në çdo ndërtesë të Corewell Health.

Ndryshime në përmbajtjen e këtij njoftimi

Ne ruajmë të drejtën të ndryshojmë këtë njoftim. Gjithashtu ne ruajmë të drejtën për ta bërë njoftimin e rishikuar të vlefshëm edhe për informacionin tuaj shëndetësor që kemi marrë tashmë dhe për çdo informacion që do të mbledhim në të ardhmen. Ne do të postojmë një kopje të njoftimit aktual në ndërtesat, zyrat dhe vendndodhjet që mbulohen nga ky njoftim. Njoftimi do të përmbajë edhe datën e hyrjes në fuqi. Përveç kësaj, një kopje e njoftimit të fundit do t'ju vihet në dispozicion sa herë që regjistroheni në një institucion apo zyrë ose në rastet kur pranoheni në një institucion për trajtim mjekësor apo për shërbime të kujdesit shëndetësor, qoftë si pacient i brendshëm apo i jashtëm.

Nëse mendoni se janë shkelur të drejtat tuaja të privatësisë, mund të

paraqisni një ankesë pranë Corewell Health ose pranë sekretarisë së Departamentit të Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore (Department of Health and Human Services).

Për të paraqitur një ankesë në Corewell Health, dërgoni e-mail në privacy@corewellhealth.org ose kontaktoni: Corewell Health, Chief Privacy Officer MC168, 100 Michigan Street NE, Grand Rapids, MI 49503.

Të gjitha ankesat duhet të paraqiten me shkrim. Ju nuk do të penalizoheni kur paraqitni një ankesë.

Përdorime të tjera të informacionit tuaj shëndetësor

Përdorimi dhe dhënia e informacionit shëndetësor për arsye të tjera që nuk përmenden në këtë njoftim ose nuk parashikohen nga legjislacioni në zbatim për Corewell Health do të bëhet vetëm me lejen tuaj të dhënë me shkrim. Nëse na jepni leje për të përdorur ose dhënë informacionin tuaj mjekësor, ju keni të drejtë ta revokoni në çdo kohë lejen e dhënë me shkrim. Në rast se revokoni lejen që keni dhënë, ne nuk do të përdorim dhe as japim informacionin tuaj shëndetësor për arsyet që përcaktohen në autorizimin tuaj me shkrim. Në këtë rast, ne nuk mund të anulohet çdo dhënie informacioni që është kryer me lejen tuaj deri në kohën e revokimit dhe na kërkohet me ligj të mbajmë shënime për shërbimet e kujdesit shëndetësor që ju kemi ofruar.

